



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti**  
**Mbledhja nr. 80/2022**  
**Prishtinë, më 24.11.2022, në orën 09:30**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni dhe Gramos Agusholli, anëtarë.

**Munguan:** Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Abelard Tahiri, Valentina Bunjaku–Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

**Të ftuar:** znj. Rozeta Hajdari, ministre e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT).

**Pjesëmarrës tjerë:** Selvije Çeku, Arta Kusari, Artan Demolli dhe Drilon Zyba, MINT, Dorentina Murturi, Kuvendi/Media, Bekim Gashi dhe Elsa Krasniqi, GP - LVV dhe mediat.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

**Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.11.2022;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-192 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit;**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.11.2022**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.11.2022, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-192 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit**

**Kryetari**, theksoi se në bazë të nenit 74 paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, para shqyrtimit të parë të projektligjit në seance plenare, Komisioni përgjegjës-raportues, i ngarkuar nga Kryetari i Kuvendit, e shqyrton projektligjin në parim dhe e procedon për seancë plenare. Komisioni i paraqet Kuvendit raport me rekomandime për miratim ose për mosmiratim të projektligjit. Sot kemi në shqyrtim Projektligjin nr. 08/L-192 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit. Së pari ia kaloj fjalën ministres për ta arsyetuar projektligjin dhe mandej e hapim debatin.

**Znj. Rozeta Hajdari, ministre e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)**, duke prezantuar projektligjin theksoi se qëllimi i këtij projektligji është fuqizimi i konsumatorit për rol aktiv në treg që ushtron të drejtat dhe fuqinë e tij të zgjedhjes së mirëinformuar për vlerën e mallrave dhe shërbimeve të pranuar. Politikat e mirëfillta të hartuara dhe zbatuara për mbrojtjen e konsumatorit iu mundëson atyre të bëjnë zgjedhje të mirëinformuara duke ndikuar pozitivisht në krijimin e një konkurrence dhe rritje të qëndrueshme. Gjithashtu, ligji ka për qëllim garantimin e qarkullimit të lirë të produkteve të sigurta në treg. Projektligji është hartuar në mënyrë që të bëhet harmonizimi i mëtutjeshëm me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni evropian. Prandaj, kërkoj që ky projektligj të miratohet dhe të procedohet në shqyrtim të mëtejshëm.

**Selviqe Çeku, MINT**, theksoi se ky projektligj është edhe detyrim nga marrëveshja e MSA-së, dhe se po ashtu, me ndryshimet e direktivave bazë, që katër direktiva të BE-së janë shkruar në një, kanë imponuar plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit. Arsyeshmëria pse ka ardhur ky projektligj janë edhe masat ndëshkuese, përmbajtja e tregut elektronik, blerjet digjitale, mbrojtja kolektive.

**Driton Hyseni**, tha se te neni 40 i projektligjit që lidhet me shoqatat për mbrojtjen e konsumatorëve, thuhet se Ministria merr pjesë në ngritjen e kapaciteteve të shoqatave. Sa janë aktive në këtë fazë këto shoqata për mbrojtjen e konsumatorëve? Si do të jetë roli i Ministrisë në ngritjen e kapaciteteve të këtyre shoqatave? Konsideroj se Ministria është ajo që duhet të bartë barrën për mbrojtjen e konsumatorit. Si do të ndahet fusha e veprimit mes ministrisë dhe shoqatave? Po ashtu, te neni 71, thuhet se inspektori kompetent mund të udhëzojë tregtarin për të kompensuar konsumatorin. Konsideroj që është rrugë e gjatë që konsumatori t'i drejtohet gjykatave për kompensim, dhe mendoj që fjala “mund të udhëzojë” propozoj të jetë “duhet”, të jetë obliguese për inspektoratin që ta detyrojë tregtarin që të kompensojë konsumatorin.

**Ministrja** sqaroi se lidhur me shoqatat për mbrojtjen e konsumatorëve, ne kemi disa shoqata që janë aktive. Duke u nisur nga praktika që sektori privat dhe konsumatori nuk janë mirë të koordinuar dhe qëllimi jonë është të kemi sa më shumë përfaqësim, zë më të fuqishëm të sektorit privat dhe të konsumatorëve që të kontribuojnë në politika më të mirë tregtare në raport me konsumatorin. Ne përmes Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit, ku është pjesë edhe Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe presim që të ketë angazhim në mbrojtjen e konsumatorit. Ne synojmë të forcojmë zërin e konsumatorit dhe sektorit privat në kontributin e tyre për politikën e qeverisë. Lidhur me komentin rreth fjalës “mund të udhëzoj” që të bëhet “duhet të udhëzoj” pajtohem që në proces të shqyrtimit të rregullohet.

**Driton Hyseni**, pyeti se a janë marrë për bazë komentet e shoqatës ekzistuese gjatë hartimit të projektligjit? Edhe tek biletat e udhëtarëve, mendoj që konsumatori duhet të jetë më mirë i informuar duke dhënë informata për çmimet e parametrave përbërës të totalit të çmimit të biletës dhe secilit produkt apo shërbim që ka parametra përbërës.

**Ministrja** theksoi se pajtohet propozimin, por këtë herë ky projektligj u bë për harmonizim me direktivat. Të shohim në të ardhmen, të bëjmë një projektligj të ri me të gjitha komponentët që mendohet të rregullohen. Jemi dakord për informim të konsumatorëve me çmimin e parametrave përbërës të një produkti.

**Kryetari** theksoi se sot kemi seancë dhe debatin po e mbyllim, kurse në mes të dy leximeve do të japim kontributin tonë në grupin punues, që do të punojë në projektligj.

*Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

#### *Përfundim*

*I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr. 08/L-192 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit.*

#### **4. Të ndryshme Çështjet vijuese.**

**Mbledhja përfundoi në orën 10:00.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Ferat Shala,**

-----  
**Kryetar i Komisionit**